



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“KONSTRUKSIONE METALIKE”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

F2-III-23

Tiranë, 2023

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Konstruksione metalike”			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	F2-III-23
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional profili “Konstruksione metalike” niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për konstruksionet metalike për fushën e mekanikës, si dhe të zhvillojë personalitetin e individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin “Konstruksione metalike” të nivelit të tretë në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme të drejtimit “Mekanikë”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; - janë në gjendje shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucioni përgjegjës përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla.</p>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Konstruksione metalike” niveli III-të, në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë fushë dhe suplementin përkatës. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të shërbimeve mekanike, në pika shërbimi të prodhimit dhe montimit të konstruksioneve metalike, në ndërmarrje ndërtimi dhe njësi të tjera ekonomike me fokus në prodhimin dhe montimin e konstruksioneve metalike, si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e konstruksioneve mekanike dhe të ngjashme.</p> <p>Me përfundimin e arsimit në “Konstruksione metalike” niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individit ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV në KSHK referuar nivelit IV të KEK,. Me arsimim të mëtejshëm fiton të drejtën e diplomës e “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesëm dhe universitare.</p>			
Data validimit	Korrik 2023			
Data miratimit				
Variantet mëparshme	F-II-02-12, F2-III-18			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Planifikimi, përgatitja dhe organizimi i prodhimit të konstruksioneve metalike

- Të përshkruajë zhvillimet në fushën e konstruksioneve metalike dhe tendencat përkatëse teknologjike;
- Të përshkruajë kuadrin ligjor dhe profesionet në industrinë mekanike;
- Të përshkruajë rëndësinë e planifikimit të prodhimit dhe parimet bazë të tij;
- Të përshkruajë domosdoshmërinë e planifikimit të kohës dhe burimeve të kërkuara sipas dokumentacionit përkatës teknik dhe teknologjik;
- Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e një reparti të konstruksioneve metalike;
- Të përshkruajë elementet e një Urdhër pune;
- Të klasifikojë fazat e procesit të punës sipas një proces të rregullt;
- Të tregojë mënyrën e plotësimit të dokumenteve të veprimtarisë ditore dhe javore;
- Të përshkruajë instruksionet verbale në procesin e punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e disiplinës në grup dhe përpikërinë orare të çdo veprimi;
- Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit dhe koordinimit me teknikë të tjerë;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore sipas proceseve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit dhe sistemimit të vendit të punës;
- Të listojë llojet e mjeteve, veglave dhe pajisjeve, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes paraprake të kohës së punimeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së detyrave në ekip.
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullores së brendshme.

Materialet e konstruksioneve

- Të kategorizojë llojet e materialeve, sipas përbërjes dhe vetive fizike, kimike, mekanike dhe teknologjike;
- Të dallojë materialet bazë në funksion të saldueshmërisë së tyre;
- Të shpjegojë procesin e ngurtësimit gjatë saldimit;
- Të dallojë tipat e ndryshme të plasaritjeve (në të nxehtë, në të ftohtë, lodhje) duke shpjeguar zonat, shkaqet e mundshme dhe elementët që influencojnë në plasaritjet mekanike;
- Të dallojë tipat e ndryshme të veshjeve të çeliqueve;
- Të përshkruajë materialet mbrojtëse të sipërfaqes së elementeve konstruktivë
- Të shpjegojë vetitë kryesore fizike dhe kimike, përdorimet kryesore praktike të çeliqueve inoks (të pandryshkshëm), përbërjen dhe influencën e elementeve të ndryshëm në lidhje;
- Të dallojë gizat: e bardhë, e zezë, maleabel, speciale (e lidhur), nodulare në bazë të përbërjes së tyre dhe të saldueshmërisë;
- Të dallojë llojet e materialeve jo ferroze dhe lidhjet e tyre, sipas dokumentacionit teknik dhe përdorimit përkatës në konstruksionet metalike;

Makineri dhe pajisje

- Të përshkruajë mënyrën e zgjedhjes dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve në funksion të materialit dhe formës së kërkuar;
- Të shpjegojë parimin fizik të prerjes me tranxha;
- Të shpjegojë mbi bazën e dokumentacionit përkatës karakteristikat kryesore të tranxhës dhe funksionimin e saj;
- Të dallojë në bazë të dokumentacionit përkatës, pajisjet shpuese, prerëse dhe formuese;
- Të dallojë prerjen me tranxhe, me sharrë, me stampim, me prerje me kanelle;
- Të shpjegojë parimin e punës së makinës kthyesë;
- Të shpjegojë principin e punës të një makine drejtimi mekanik, pneumatike dhe një makine drejtimi me rrula;
- Të përshkruajë, mbi bazën e dokumentacionit, karakteristikat dhe parimet e funksionimit të presave kryesore me levë dore për kthimin e shufrave;
- Të shpjegojë funksionimin e gjeneratorëve dinamike, transformatorëve të rrymës dhe të inverterit;
- Të shpjegojë funksionimin, masat e montimit, të përdorimit, dhe mirëmbajtjes që duhen respektuar për pincat mbajtëse të elektrodës ;
- Të shpjegojë mjetet termike dhe mekanike të përdorura për korrigjimin e deformacioneve dhe reduktimin e tensioneve të mbetura gjatë saldimit;
- Të shpjegojë instrumentet matës dhe kontrollues të përmasave, të formës, të pozicionit dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e saktësisë e instrumenteve matëse, përdorimin e tyre, kontrollin e brendshëm, kalibrimin;
- Të shpjegojë metodikat e matjes me instrumentet matës;

Interpretimi i dokumentacionit teknik e teknologjik

- Të interpretojë dokumentacionin teknik dhe teknologjik të prodhimit të konstruksioneve metalike;
- Të shpjegojë zbërthimin/përshkrimin e projektit të konstruksionit metalike sipas normave evropiane EN³ dhe ndërkombëtare ISO⁴;
- Të interpretojë vizatimet e nyjave sipas normave evropiane EN dhe ndërkombëtare ISO;
- Të përshkruajë mënyrën e nxjerrjes nga vizatimi i nyjës të një ose më shumë elementëve;
- Të tregojë mënyrën e kryerjeve të matjeve të duhura me qëllim realizimin e bashkimeve të elementeve në nyje;
- Të shpjegojë një plan izometrik të thjeshtë 3D;
- Të interpretojë skicën e një detali të nxjerrë nga një vizatim nyjeje;
- Të interpretojë simbolet e saldimit, sipas EN;

Prodhimi i elementëve të konstruksioneve metalike

³ European Norms

⁴ International Organization for Standardization

- Të shpjegojë parimin e përpunimit plastik të elementeve konstruktivë me pajisje dhe makina metalpunuese
- Të shpjegojë rregullat e përgjithshme të palosjes;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së zgjatimit të llamarinës gjatë palosjes;
- Të shpjegojë parimin e palosjes me dorë të llamarinave të holla dhe me dimensione të vogla;
- Të shpjegojë parimin themelor dhe procedurën e palosjes me presë;
- Të shpjegojë dhe të skematizojë procesin e palosjes së thjeshtë dhe të shumëfishtë;
- Të tregojë ndryshimet e strukturës gjatë palosjes (produkte të sheshta dhe profile klasike LT, U);
- Të shpjegojë influencën e palosjes në dimensionet gjeometrike të shufrave;
- Të shpjegojë procesin e kthimit cilindrik, konik në makinat përkatëse;
- Të shpjegojë procesin e përpunimit mekanik të elementeve konstruktivë me heqje të ashklës;
- Të shpjegojë karakteristikat e instrumenteve prerës për metalet kryesore ferroke dhe joferroke;
- Të shpjegojë procesin e përgatitjes së elementeve konstruktivë me material të shkrirë;

Bashkimi i elementëve konstruktiv me lidhje të ndashme dhe elastike

- Të shpjegojë teknikat e përgatitjes së elementeve konstruktive në bashkime me lidhje të ndashme dhe elastike;
- Të shpjegojë përdorimin e pajisjeve në bashkime me lidhje të ndashme dhe elastike;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e fiksimit të elementeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit në radhën e montimit;
- Të listojë elementët bashkues në lidhjet e ndashme dhe elastike;
- Të shpjegojë procesin e bashkimit të elementeve konstruktivë me lidhje me fileto;
- Të shpjegojë procesin e bashkimit të elementeve konstruktivë me lidhje me kiaveta dhe shliza;
- Të shpjegojë procesin e bashkimit të elementeve konstruktivë me lidhje me elementë elastikë;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të elementeve elastik (gominat, sustat apo elemente të tjerë fleksibël etj.) ndërmjet pjesëve, për realizimin e bashkimeve;

BASHKIMI I ELEMENTËVE KONSTRUKTIV ME LIDHJE TË PANDASHME

Saldim

- Të shpjegojë teknikat e përgatitjes së elementeve konstruktive për saldim;
- Të shpjegojë përdorimin e pajisjeve për saldim;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e fiksimit të elementeve;
- Të shpjegojë parametrat e regjimit të saldimit sipas llojit të saldimit dhe kartës teknologjike;
- Të shpjegojë mënyrat e saldimit, si dhe pajisjet dhe materialet e nevojshme;
- Të shpjegojë procesin e prerjes me oksigjen dhe teknologjinë përkatëse;
- Të shpjegojë kushtet e përgjithshme të prerjes me oksigjen të materialeve;
- Të përshkruajë prerjen me oksigjen të gizave dhe çeliqueve të lidhur;

- Të shpjegojë proceset OX-AD⁵ dhe Hark O₂ dhe përparësitë e secilit.(Hark-ajër);
- Të tregojë tipin e elektrodës dhe rrymën e nevojshme në varësi të metalit;
- Të listojë defektet kryesore të prerjes dhe masat përmirësuese;
- Të përshkruajë kufijtë e përdorimit për prerjen e çelikeve (Ox-gaz) me dorë ;
- Të shpjegojë parimet fizike të prerjes me oksigaz;
- Të interpretojë zgjedhjen e tipit të kokës së kanellës prerëse ;
- Të shpjegojë prerjen L.A.S.E.R;
- Të shpjegojë parimin teknologjik të kryerjes së procesit të prerjes L.A.S.E.R;
- Të përshkruajë parimin e prerjes plazma;
- Të shpjegojë përdorimin specifik të prerjes me dorë dhe automatike;
- Të shpjegojë fazat e mekanizmit të prerjes « plasma »;
- Të shpjegojë influencën e vetive të aluminit gjatë saldimit;
- Të shpjegojë kuptimin e forcimit struktural, si dhe ndikimin në vetitë mekanike;
- Të shpjegojë influencën e H₂ në homogjenitetin metalik të tegelit të saldimit;
- Të shpjegojë karakteristikën e saldimit me Ox-AD të saldimit autogjen, me shkrirje të elektrodës, me ngjitje;
- Të shpjegojë një instalim të përgjithshëm Ox-AD për saldim dhe mënyrat e magazinimit të gazit;
- Të dallojë përparësitë dhe të metat e saldimit OA;
- Të shpjegojë masat e përdorimit dhe të ruajtjes, mënyrat e largimit të flukseve pas operacionit të ngjitjes;
- Të shpjegojë fenomenin e bymimit dhe të tkurrjes, si dhe efektet e tyre mbi elementet që saldohen;
- Të shpjegojë saldimin sipas procesit me hark dhe fluks gazi inert (MAG).
- Të shpjegojë llojin dhe nevojën e përdorimit të pajisjeve të saldimit gjysmë-automatik;
- Të shpjegojë rëndësinë e distancës tub-kontakt në mbrojtjen e banjës së shkrirjes, rregullimi dhe stabiliteti i rrymës gjatë saldimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së temperaturës së duhur gjatë saldimit;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe mënyrën e saldimit sipas procesit T.I.G. (volfram, Inert Gaz);
- Të përshkruajë një instalim saldimi me TIG;
- Të shpjegojë ndryshimet midis kanellës O-A dhe harkut me procesin TIG;
- Të rendisë përparësitë dhe të metat e procesit TIG dhe fushë-përdorimi i tij;
- Të shpjegojë tipat e rrymës së përdorur (A.C – D.C) polariteti direkt dhe invers;
- Të shpjegojë procesin e saldimit me metodën nën presion, pajisjet dhe materialet e nevojshme;
- Të shpjegojë metodat e ngjitjes dhe fushë-përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë metodat dhe materialet për ngjitjet me materiale plastike;
- Të shpjegojë rëndësinë e pastrimit të tegelave;
- Të listojë llojet e defekteve, metodat e kontrollit të tegelit të saldimit, pajisjet përkatëse (NDT) dhe mënyrat e korigjimit të tyre;

⁵ Oksigjen/Acetilen

- Të shpjegojë kontrollet jo-shkatërruese të tegelave të saldimit (Kontrolli vizual; kontrolli me penetrim, kontrolli me ultra-tinguj, kontrolli me radiografi, me grimca magnetike; fusha e aplikimit të tyre, pajisjet e kontrollit, mënyra e përdorimit, kufizimet e tyre);

Percinim/ribatim dhe ngjitje

- Të shpjegojë llojet e bashkimeve me percinim/ribatim;
- Të listojë llojet e percinave dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë pajisjet dhe makineritë për procesin e percinim/ribatim;
- Të shpjegojë procesin e bashkimit me percinave;
- Të përshkruajë llojet e silikoneve ose rezinave dhe përdorimet të tyre
- Të përshkruajë operacionet teknologjike, përgatitjen e elementëve për bashkim, mënyrën e aplikimit të tyre, kohën e tharjes etj.;

Montimi dhe çmontimi i konstruksioneve metalike

- Të listojë llojet e pajisjeve dhe mjeteve të punës në montim/çmontim;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së montimit/çmontimit;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së shabllonëve për montim sipas vizatimit
- Të përshkruajë rëndësinë e përcaktimit të qendrës së rëndësës të konstruksioneve;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kartës teknologjike të montimit;
- Të përshkruajë mënyrat e pastrimit të elementëve konstruktivë nga skoriet/papastërtitë e krijuara gjatë proceseve të punës;
- Të shpjegojë mënyrat e mbrojtjes të sipërfaqeve të elementeve konstruktivë;
- Të shpjegojë mënyrat e markimit dhe etiketimit të konstruksionit;
- Të përshkruajë teknikat e pastrimit, konservimit, paketimit dhe ambalazhimit të konstruksioneve metalike;

Mirëmbajtje dhe riparime bazë të elementëve të konstruksioneve metalike

- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kalendarit të shërbimeve të mirëmbajtjes të pajisjeve dhe makinerive;
- Të listojë llojet shërbimeve të mirëmbajtjes të konstruksionit metalik;
- Të listojë shërbimeve të mirëmbajtjes të pajisjeve dhe makinerive;
- Të listojë llojet e materialeve për mirëmbajtje dhe riparim;
- Të përshkruajë rëndësinë e regjistrimeve të parametrave sipas manualit të makinerisë/pajisjes;
- Të shpjegojë mënyrën e riparimeve të elementëve të konstruksionit që kanë nevojë për riparime;
- Të listojë llojet e dokumentacioneve për shërbimet e kryera;

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të shpjegojë sipërmarrjen me të gjitha elementet kryesore të saj;
- Të shpjegojë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;

- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të shpjegojë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes;
- Të shpjegojë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre;
- Të përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit;
- Të argumentojë rolin e TIK në komunikimin global (reklama, shitje, blerje, etj.);
- Të përshkruajë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën e ndërtimit;
- Të shpjegojë planet ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët;
- Të përshkruajë përgatitjen e raporteve periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të shpjegojë hapat për vendosjen e çmimit përfundimtar për shërbimet e ofruara;
- Të shpjegojë mënyrën e plotësimit të procesverbalit të dorëzimit të punimeve;
- Të rendisë format dhe mënyrat e përpilimit, si dhe të arkivimit të dokumentacioneve;
- Të argumentojë kontrollin e çmimit të tregut të materialeve e pajisjeve sipas standardit të ndërtimit;
- Të përshkruajë llogaritjet e kostos së materialeve dhe çmimet e një shërbimi të kryer;
- Të rendisë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të shpjegojë mënyrat e blerjes së materialeve dhe pajisjeve të ndryshme;
- Të interpretojë zbatimin e teknikave të marketingut për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të nënvizojë metodat e zhvillimit të karrierës;
- Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit të njohurive për aplikimin e teknikave të reja në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, kontrollit të furnitorit, kontrollit të proceseve dhe të produktit përfundimtar;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të rendisë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të nënvizojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të nënvizojë rëndësinë e marrëdhënieve me bashkëpunëtorët dhe rolin i tyre në veprimtarinë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve duke përdorur teknikat e duhura të komunikimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të
- Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes me bashkëpunëtorët;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e punës në grup;
- Të shpjegojë rregullat dhe domosdoshmërinë e koordinimit të veprimtarive me kolegët dhe vartësit;
- Të përshkruajë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;

Siguria në punë dhe mbrojtja në mjedisit

- Të përshkruajë rëndësinë e sigurisë së vendit të punës ;
- Të përshkruajë masat e sigurisë që merren gjatë përdorimit të veglave dhe mjeteve të punës, për respektimin e sigurisë së personave, pasurisë dhe ambientit;
- Të përshkruajë strukturën e një vendi pune për saldim me gaz individual dhe kolektiv, prerje OX-AD;
- Të shpjegojë pozicionin dhe dobinë e secilit element të sigurisë;
- Të shpjegojë, në një tabelë përmbledhëse, anomalitë dhe mënyrat e përmirësimit të tyre në rastet e shkëputjeve dhe vibrimeve, shuarjen e menjëhershëm, çrregullim i vazhdueshëm i flakës dhe kthim i flakës;
- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit dhe ruajtjes së parametrave të (temperaturës dhe të presionit) bombolës C₂H₂;
- Të shpjegojë rëndësinë e rregulloreve të përgjithshme dhe të veçanta që kanë të bëjnë me mbrojtjen individuale dhe kolektive të punonjësve gjatë punës;
- Të përshkruajë standardet kombëtare/ndërkombëtare për sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë (Standardi ISO 45001:2018)⁶;
- Të shpjegojë rëndësinë e procedurave të evakuimit për raste të ndryshme emergjence;
- Të shpjegojë rëndësinë e dhënies së ndihmës së parë, (mjetet e përdorimi i tyre dhe procedurat);
- Të shpjegojë pikat kritike për ndotjen e mjedisit gjatë procesit të punës, menaxhimi i tyre dhe minimizimi i riskut;
- Të përshkruajë standardet kombëtare/ndërkombëtare për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015⁷;
- Të përshkruajë rreziqet për shëndetin dhe mjedisin që lindin gjatë përdorimit të solucioneve kimike me rrezikshmëri të lartë;
- Të përshkruajë rreziqet për sigurinë e jetës dhe mjedisin që lindin gjatë përdorimit të materialeve të ndezshme dhe bombolave të gazit;
- Të shpjegojë rreziqet për sigurinë e jetës dhe mjedisin gjatë përdorimit të pajisjeve elektrike për saldime;
- Të përshkruajë masat që merren për menaxhimin dhe përdorimin me eficiencë të energjisë në kompani gjatë procesit të punës.(Standardi ISO 50001:2018⁸)

SHPREHI PROFESIONALE

Planifikimi, përgatitja dhe organizimi i prodhimit të konstruksioneve metalike

- Të organizojë punën në një repart të konstruksioneve metalike;
- Të koordinojë punën me specialistë dhe teknikë të tjerë;
- Të planifikojë dhe menaxhojë burimet njerëzore sipas proceseve të punës;
- Të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- Të kryejë llogaritje paraprake të kohës së punës për realizimin e detyrave sipas dokumentacionit përkatës teknik dhe teknologjik;

⁶ Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë - Kërkesat me udhëzime për përdorim

⁷ Sistemet e menaxhimit mjedisor - Kërkesat me udhëzime për përdorim

⁸ Sistemet e menaxhimit të energjisë - Kërkesat me udhëzim për përdorim

- Të ndajë detyrat në ekip;
- Të zbatojë rregulloren e brendshme;
- Të respektojë parimet bazë të planifikimit të prodhimit;
- Të përzgjedhë, gjatë prodhimit të konstruksioneve, teknologjitë përkatëse dhe teknologjitë e reja të zhvillimit në industri;
- Të zbatojë kuadrin ligjor në industri dhe profesionet në industrinë mekanike;
- Të zbatojë Urdhrin e punës në prodhim;
- Të organizojë proceset e punës sipas kartës teknologjike;
- Të plotësojë dokumentet e veprimtarisë ditore dhe javore sipas formateve të kërkuara;
- Të zbatojë instruksionet verbale në procesin e punës;
- Të zbatojë, gjatë punës në grup, disiplinën dhe realizimin në kohë të çdo detyre;
- Të zbërthejë dokumentacionin teknik dhe teknologjik të prodhimit të konstruksioneve metalike;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për proceset e punës;

Materialet e konstruksioneve

- Të përzgjedhë llojet e materialeve, sipas përbërjes dhe vetive fizike, kimike, mekanike dhe teknologjike;
- Të përzgjedhë materialet bazë në funksion të saldueshmërisë së tyre;
- Të përcaktojë tipat e ndryshme të plasaritjeve në materiale (në të nxehtë, në të ftohtë, lodhje) duke shpjeguar zonat, shkaqet e mundshme dhe elementët që influencojnë në plasaritjet mekanike;
- Të përcaktojë tipat e ndryshme të veshjeve të çeliqueve;
- Të përzgjedhë materialet mbrojtëse të sipërfaqes së elementeve konstruktive sipas kartës teknologjike;
- Të zgjedhë tipat kryesore të çeliqueve inoks, sipas karakteristikave të tyre fizike dhe mekanike;
- Të përzgjedhë gizat: e bardhë, e zezë, maleabel, speciale (e lidhur), nodulare sipas dokumentacionit teknik dhe përdorimit përkatës në konstruksionet metalike;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve jo ferroze dhe lidhjet e tyre, sipas dokumentacionit teknik dhe përdorimit përkatës në konstruksionet metalike;

Makineri dhe pajisje

- Të përzgjedhë pajisjet, makineritë përkatëse, instrumentet dhe mjetet e punës sipas materialit që punohet dhe formës së kërkuar të elementeve;
- Të përdorë pajisjet, makineritë përkatëse, instrumentet dhe mjetet e punës për përgatitjen e elementeve konstruktive;
- Të kryejë kontrollin e funksionimit të makinerive sipas manualit të përdorimit;
- Të përgatisë pajisjet, makineritë për punë sipas manualit dhe procesit që kryhet;
- Të përzgjedhë dhe të montojë tek secila makineri, instrumente dhe pajisjet përkatëse;
- Të përzgjedhë dhe përdorë në bazë të dokumentacionit përkatës, pajisjet shpuese, prerëse dhe formuese;
- Të përdorë pajisjet përkatëse në bashkimet me lidhje të ndashme dhe elastike;
- Të përdorë gjeneratorët dinamike, transformatorët e rrymës dhe inverterin;

- Të përdorë tranxhën, kalandrën, piegatricen dhe presën sipas manualit përkatës;
- Të përgatisë dhe përdorë pajisjet e saldimit sipas llojit të saldimit;
- Të përzgjedhë mjetet termike dhe mekanike të përdorura për korrigjimin e deformimeve dhe reduktimin e tensioneve të mbetura gjatë saldimit;
- Të përzgjedhë dhe përgatisë pajisjet dhe instrumentet e nevojshme për kontrollin e cilësisë së tegelave të saldimit sipas manualit përkatës;

Prodhimi i elementëve të konstruksioneve metalike

- Të zbatojë teknikat e matjes dhe shënimit në elementet konstruktive sipas vizatimit të detalit;
- Të përgatitë llamarinat ose profilet sipas rregullave të përgjithshme dhe zgjatimit të llamarinës gjatë palosjes;
- Të regjistrojë parametrat për makinat metalpunuese në funksion të materialit dhe të punimit që do të kryhet, sipas kartës teknologjike;
- Të kryejë dhënie të formave në të ftohtë dhe në të nxehtë të elementeve sipas kartës teknologjike;
- Të realizojë palosjen me dorë të llamarinave të holla dhe me dimensione të vogla;
- Të kryejë palosje me anë të presave (mekanike dhe hidraulike);
- Të kryejë procesin e palosjes së thjeshtë dhe të shumëfishtë;
- Të kryejë procesin e kthimit cilindrik, konik dhe në makinat e tipit piramidale;
- Të realizojë punime barenimi, shpimi, zdrugimi, zmerilimi etj. në elementet konstruktive sipas kartës teknologjike;

Bashkimi i elementëve konstruktiv me lidhje të ndashme dhe elastike

- Të zbatojë mënyrat e fiksimit të elementeve konstruktive;
- Të zbatojë radhën e montimit të elementeve konstruktive;
- Të realizojë procesin e bashkimit të elementeve konstruktive me lidhje me fileto;
- Të realizojë procesin e bashkimit të elementeve konstruktive me lidhje me kiaveta dhe shliza;
- Të realizojë procesin e bashkimit të elementeve konstruktive me elementë elastikë;
- Të zbatojë teknikat e kontrollit sipas kartës teknologjike;
- Të realizojë korrigjimet e nevojshme për defektet e identifikuara;
- Të përdorë elementë elastik (gominat, sustat apo elemente të tjerë fleksibël etj.) ndërmjet pjesëve, për realizimin e bashkimeve;

BASHKIMI I ELEMENTËVE KONSTRUKTIV ME LIDHJE TË PANDASHME

Saldim dhe ngjitje

- Të realizojë përgatitjen e elementeve konstruktive për saldim;
- Të përgatisë detalet për t'i bashkuar (pastrim dhe zmuso);
- Të realizojë pozicionimin e elementeve konstruktive;
- Të përzgjedhë mënyrën e saldimit, me pajisjet dhe materialet e nevojshme, sipas kartës teknologjike;

- Të përzgjedhë mënyrën e prerjes, me pajisjet dhe materialet e nevojshme, sipas kartës teknologjike;
- Të regjistrojë parametrat e regjimit të saldimit sipas llojit të saldimit ose kartës teknologjike;
- Të realizojë procesin e prerjes me oksigjen me teknologjinë përkatëse, për materiale të ndryshme;
- Të realizojë proceset e prerjes me hark-ajër;
- Të realizojë prerjen me plazëm;
- Të riparojë defektet që lindin gjatë krijimit të xhepave me mbetje metali, çarje, krisje;
- Të realizojë një instalim të përgjithshëm të pajisjeve për saldim me gaz;
- Të realizojë praktikisht një flakë djegëse, reduktuese (neutrale) dhe oksiduese;
- Të ilustrtojë pozicionin e saldimit (në funksion të normalizimit);
- Të përdorë metodat e saldimit, në të majtë, të sheshtë, gjysmë të ngritur, në një dhe dy kalime;
- Të kryejë saldime me një ose me shumë kalime (të mbivendosura);
- Të përgatisë buzët e elementeve për konstruksione, për saldime të ndryshme (kokë më kokë dhe një mbi një, me anë të ngritura, me anë të drejta me dhe pa mbështetje dhe në kënd të jashtëm pa metal shtesë në elementin me trashësi të vogël dhe me trashësi të njëjtë);
- Të kryejë një saldim me gaz trashësia - 2mm;
- Të kryejë operacionin e saldimit **me hark me elektroda të veshura (EV)**;
- Të zgjedhë llojin e gazit mbrojtës (CO₂ ose përzierje, argon, përzierje, ...);
- Të zgjedhë regjimin e përafërt të harkut (spray – hark, hark i shkurtër, hark pulsues) në funksion të përdorimit;
- Të përcaktojë parametrat (I, U, sasia e gazit, shpejtësia e avancimit) për llojin e caktuar të aparaturës së instaluar;
- Të kryejë centrimin dhe pikimin e nevojshëm të elementëve që do të bashkohen;
- Të realizojë saldimin sipas procesit me hark dhe fluks gazi inert (MIG) dhe gazi aktiv (MAG) duke respektuar rregullat e sigurisë individuale dhe kolektive në punë;
- Të realizojë saldimin sipas procesit T.I.G. (volfram, Inert Gaz);
- Të realizojë procesin e saldimit me metodën nën presion, me pajisjet dhe materialet e nevojshme;
- Të marrë masa për të minimizuar fenomenin e bymimit dhe tkurrjes, si dhe efektet e tyre mbi elementet që saldohen;
- Të korrigjojë deformimet gjatë pikimit dhe saldimit (duke bërë korrigjimet e duhura në kohë);
- Të realizojë pastrimin e tegelave;
- Të përcaktojë defektet me metodat e kontrollit të tegelit të saldimit, me pajisjet përkatëse (NDT⁹);
- Të kryejë korrigjimet e nevojshme gjatë dhe pas operacionit të saldimit (dimensionale, gjeometrike dhe cilësore);
- Të vendosë në pozicion elementet që do të ngjitet;
- Të përzgjedhë kanellën e duhur për ngjitje;
- Të montojë një kanelle dhe të rregullojë flakën për ngjitje;

⁹ NDT-Prova jo shkatërruese

- Të kryejë ngrohjen dhe vendosjen e metalit shtesë duke kryer një kalim të plotë;
- Të realizojë ngjitjen e elementeve kontruktivë;
- Të realizojë ngjitjen e materialeve plastike me metoda te ndryshme;
- Të marrë masat për përdorimin, ruajtjen dhe mënyrat e largimit të fluseve pas operacionit të ngjitjes;
- Të kontrollojë cilësinë e ngjitjes të elementëve kontruktivë;

Ribatinim dhe ngjitje

- Të realizojë përgatitjen paraprake të elementëve për ribatinim;
- Të përzgjedhë llojet e percinave, formën dhe përmasat sipas përdorimit të tyre;
- Të realizojë procesin e bashkimit me ribatinim;
- Të kontrollojë cilësinë e lidhjes me ribatinim;
- Të përzgjedhë llojet e silikoneve ose rezinave sipas përdorimit të tyre;
- Të realizojë lidhje me ngjitje duke zbatuar teknologjitë përkatëse;

Montimi dhe çmontimi i konstruksioneve metalike

- Të përzgjedhë mënyrën e përgatitjes së shabllonëve për montim sipas kartës teknologjike;
- Të përcaktojë qendrën e rëndesës të konstruksionit;
- Të zbatojë radhën e montim/çmontimit sipas kartës teknologjike;
- Të zbatojë mënyrat e pastrimit të elementëve konstruktivë nga skoriet/papastërtitë e krijuara gjatë proceseve të punës;
- Të zbatojë mënyrat e mbrojtjes të sipërfaqeve të elementeve konstruktivë;
- Të kryejë markimin dhe etiketimin e konstruksionit;
- Të zbatojë teknikat e konservimit, paketimit dhe ambalazhimit të konstruksioneve metalike;

Mirëmbajtje dhe riparime bazë të elementëve të konstruksioneve metalike

- Të zbatojë kalendarin e shërbimeve të mirëmbajtjes në makineritë dhe pajisjet e konstruksioneve metalike;
- Të kryejë shërbime të mirëmbajtjes të konstruksionit metalik;
- Të kryejë shërbime të mirëmbajtjes të pajisjeve dhe makinerive;
- Të përdorë materialet e duhura për mirëmbajtje dhe riparim;
- Të kryejë regjistrime të parametrave sipas manualit të makinerisë/pajisjes;
- Të kryejë riparime të elementëve të konstruksionit sipas dokumentacionit teknik dhe teknologjik;
- Të plotësojë të gjitha llojet e dokumentacioneve për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit;

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të analizojë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të përcaktojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të kuptojë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;

- Të bashkëpunojë me institucionet financiare për aktivitetin e biznesit;
- Të zbatojë legjislacionin dhe etikën në biznes;
- Të përdorë TIK në komunikimin global (reklama, shitje, blerje, etj.);
- Të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën e ndërtimit;
- Të përgatisë planet ditore, javore, mujore të punës në përputhje me detyrat;
- Të kryejë regjistrimin e të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët;
- Të përgatisë raportet periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të zbatojë hapat për vendosjen e çmimit përfundimtar për shërbimet e ofruara;
- Të plotësojë procesverbalin e dorëzimit të punimeve sipas porosisë së klienti;
- Të përcaktojë format dhe mënyrat e përpilimit e arkivimit të dokumentacioneve;
- Të kontrollojë çmimin e tregut të materialeve e pajisjeve sipas standardit të ndërtimit;
- Të kryejë llogaritjet e kostos së materialeve dhe çmimet e një shërbimi të kryer;
- Të përgatisë një ofertë për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të realizojë blerjen e materialeve dhe pajisjeve të ndryshme;
- Të zbatojë teknikat e marketingut për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të planifikojë hapat për karrierën bazuar në vendimmarrje;
- Të përditësojë njohuritë për aplikimin e teknikave të reja në punë;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të zbatojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të përdorë terminologjinë profesionale;
- Të bashkëpunojë me të tjerë në veprimtarinë e vet profesionale;
- Të zgjidhë ankesat dhe mosmarrëveshjet duke përdorur teknikat e duhura të komunikimit;
- Të vlerësojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes me bashkëpunëtorët;
- Të punojë në ekip duke zbatuar parimet e punës në grup;
- Të zbatojë rregullat dhe domosdoshmërinë e koordinimit të veprimtarive me kolegët dhe vartësit;
- Të respektojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;

SIGURIA NË PUNË DHE MBROJTJA NE MJEDISIT

Respektimi i normave të sigurisë, të higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit

Aplikimi i Legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse në fushën e sigurimit dhe mbrojtjes në punë.

- Të respektojë legjislacionin, rregulloret e përgjithshme dhe të veçanta që kanë të bëjnë me mbrojtjen individuale dhe kolektive të punonjësve gjatë punës;
- Të identifikojë situatat me mundësi rreziku;
- Të respektojë rregulloret e Mbrojtjes Kundër Zjarrit;

- Të respektojë masat e sigurisë që merren gjatë përdorimit të veglave dhe mjeteve të punës, për respektimin e sigurisë së personave, pasurisë dhe ambientit;
- Të parandalojë rreziqet që mund të krijojnë produktet ose situatat e punës;
- Të përshtatet një qëndrim parandalues për situatat e rrezikshme;
- Të respektojë rregullat e duhura në ngritjen dhe transportimin e peshave të rënda dhe voluminoze në tërë sigurinë fiziologjike dhe materiale;
- Të respektojë rregullat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti në përputhje me procedurat;
- Të respektojë sinjalistikën në mjediset e vendit të punës;
- Të respektojë planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive;
- Të respektojë rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike sipas llojit;
- Të respektojë procedurat e sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të respektojë rregullat për pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës para, gjatë dhe pas punës;

Aplikimi i legjislacionit në fushën e mjedisit.

- Të respektojë rregullat në fushën e mjedisit;
- Të identifikojë produktet e rrezikshme, të kryejë manipulimin e duhur dhe përdorimi i kujdesshëm, në respektim të rregullave në fuqi;
- Të grumbullojë mbeturinat në respekt të rekomandimeve në fuqi për mbrojtjen e mjedisit;
- Të evakuojë mbeturinat duke respektuar rregullat në fuqi;
- Të respektojë rregullat për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve në përputhje me udhëzimet përkatëse në mënyrë që të mos rrezikojë ndotjen e mjedisit;
- Të respektojë procedurat e sistemit të menaxhimit të mjedisit;
- Të përdorë në mënyrë racionale energjinë dhe materialet, si dhe të zbatojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të zbatojë protokollat e duhura në raste pandemie;

Organizimi i saldimit sipas normave teknike

- Të përdorë mjetet për mbrojtje individuale gjatë saldimit me hark;
- Të zgjedhë me kujdes në funksion të llojit të saldimit cilësinë dhe tipin e syzeve të saldimit;
- Të zbatojë kërkesat në fushën e saldimit për lokalin, aspirimin, lyerjen e mureve dhe tavanit, largimin e vajrave, pozicionin, temperaturat, rreziku elektrik, UV, mbrojtja kolektive;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë kundër zjarrit dhe kundër shpërthimit, të kufizimit të presionit dhe rregullat mekanike të adoptuara për C2H2 (valvul moskthimi të gazit dhe të flakës, të thjeshta dhe të kombinuara;
- Të zbatojë udhëzimet dhe manualat e duhura gjatë përdorimit të bombolave të gazit nën presion, etj.

KOMPETENCA TE PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vet vlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.